



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 128

Prishtinë, më 8.10.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Nijazi Idrizi.

Mungoi : Boban Todorović, Daut Haradinaj, Salih Morina, Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 24.9.2013,
3. Shqyrtimi i projektligjit për trajtimin e ndertimeve pa leje,
4. Shqyrtimi i Strategjisë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planit të veprimit për vitin 2013-2017,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, me shtesë për pikën të ndryshme rreth licencimeve (Liburn Aliu), kërkesat për pagesat direkte për fermerët Kosovar dhe zbatimit të Ligjit për QHP (Nait Hasani) dhe ndërrimit të pikave të rendit të ditës, së pari të shqyrtohet pika 4.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.9.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24.9.2013.

3. Shqyrtimi i Strategjisë për Ajrin

Kryetari Nait Hasani para se të jap fjalën të pranishmëve për këtë dokument me rëndësi, rikujtoi agjendën e komisionit për këtë vit rreth monitorimit të Ligjit për ajrin, zhurmën etj por në mungesë të mjeteve buxhetore në Kuvend, nuk është zbatuar monitorimi në fjalë, pastaj potencoi disa sfida evidente, sidomos në kryeqytet, rreth ndotjes së ajrit dhe rritjes së prezencës së sulfurit, dioksidit të karbonit , për të cilat çështje **Nezakete Hakaj** nga MMPH premtoi se do të njoftoi kompetentët në departamentin përkatës, njëherit japi ca sqarime rreth numrit të stacioneve për monitorimin e ajrit (9 sish në Kosovë) dhe karakterin e ajrit të cilat stacione janë analizuar dhe përcaktuar përmes ekspertit nga Estonia, mirëpo ministria do të shqyrtoi edhe kërkesën nga kjo mbledhje për pikën monitoruese në Prishtinë. Kryetari **Nait Hasani** precizoi se në kryeqytet në fakt nuk funksionojnë pikat monitoruese, ndërsa rreth strategjisë në fjalë pyeti a është e punuar në bazë të raportit të progresit, për çka zyrtarja nga MMPH tha se ministria më tepër ka probleme me zbatim, përndryshe direktivat e BE kanë kosto të lartë të cilat tani e tutje do të implementohen më lehtë pasi të miratohet strategjia, gjithashtu do të ketë aplikime për leje të integruar dhe vendosje të elektro filtrave aty ku nuk janë vendosur ende në KEK. Kryetari me pyetje të ngjashme ju drejtua edhe zyrtarit të ministrisë së bujqësisë **Idriz Gashit** rreth ndotjes së tokës bujqësore pasi ngushtë ndërlidhet me ndotjen nga ajri, duke potencuar se projekti i parë për monitorimin e tokës nuk ka pasur aq sukses dhe nuk ka dhënë llogari askujt, të cilin fakt e vërtetoi edhe z. Gashi por konfirmoi se tani me projektin aktual do të analizohet toka bujqësore në 17 komuna me 250.000 ha sipas standardeve ndërkombëtare ISO, sidomos nga elementet që krijohen nga djegëja e thëngjillit dhe karburanteve të ndryshme veç e veç që ndikojnë në kualitetin e tokës. Me projektin e ri të mbështetur nga GIZ (Komisioni Evropian), vazhdoi z. Gashi, biotestet janë dërguar në Gjermani ku do të analizohet burimi i ndotjes (prej faktorit njeri apo ndonjë tjetër faktorë) dhe cilat janë efektet e tyre në bimë.

Nijazi Idrizi potencoi se ky komision ka qenë ndër të parët që ka kërkuar hulumtime për tokën bujqësore (projekti ALUP), por nga projekti i atëhershëm ka pasur pasaktësi duke konstatuar se ka pas frikë që ndotja mos po kalon edhe në ushqim, ndërsaq pas analizave të mëtejme rezultatet kanë qenë alarmante, ndaj ai kërkoi që projekti i tanishëm mundësisht të përcjellët çdo 3 muaj apo një periudë të caktuar, ngase kemi rritje të vazhdueshme të sulfurit, për çka ndoshta mirë do të ishte të ftohen zyrtarët nga MTI për analizën e derivateve të cilat hyjnë në Kosovë, sa hyjnë etj. **Idriz Gashi** në fund garantoj se ky projekt është i bazuar në komponentin ligjorë dhe së shpejti do të nxjerrët UA për krijimin e niveleve të ndotjes. **Nait Hasani** kërkoi që edhe Kuvendi të jetë në rrjedha rreth përcjelljes së punës të projektit në fjalë, njëherit ftoi komisionin për rekomandim i cili unanimisht u miratua si vijon :

R e k o m a n d i m

Komisioni miratoi projekt Strategjinë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planin e veprimit për vitin 2013-2017, dhe i propozon Kuvendit të njëjtën ta miratoi.

(Kjo strategji ende nuk është dorëzuar për mbledhje plenare, për shkak të vërejtjeve nga Departamenti ligjor rreth mos plotësimit të kushteve ligjore për miratim, për çka Sekretari i MMPH ka marr obligimin për përmirësimet e duhura).

4. Shqyrtimi i projektligjit për ndërtim pa leje

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të ftuarit rreth këtij projektligji dhe fillimisht njoftoi për vizitën e suksesshme në Kroaci rreth këtij projekti, ndaj propozoi vazhdimin e shqyrtimit të projektligjit aty ku ka mbetur komisioni në mbledhjen e fundit.

Liburn Aliu sugjeroi që të kthehet komisioni në shqyrtimin e projektligjit nga fillimi ngase nga vizita e realizuar është pa nevojë për kategorizimin edhe te ne të tokave dhe objekteve në zonat urbane dhe rurale të cilave duhet të iu sigurohen disa lehtësira nëse dëshirojmë që të ketë sukses

ligji kur hyn në fuqi, ai në vazhdim rikujtoi delegacionit që ishte në Kroaci si ishte bërë kategorizimi atje, dhe konstatoi se kjo është punë e domosdoshme që duhet bërë ngase nuk mund të trajtohen të gjitha ndërtimet njësoj, sidomos ndërtesat e larta të cilat pos tjerash duhet të përcjellën me një mendim të ekspertit-inxhinierit. **Nait Hasani** mbështeti kërkesën rreth kategorizimeve. **Afërdita Berisha** gjithashtu konstatoi se ndërtesat afariste në Kroaci kanë pas çmime të kategorizuara, ndërsa **Nijazi Idrizi** u interesua për regjistrin e këtyre ndërtimeve, sa janë, ku janë etj, ngase edhe këtu në Kosovë duhet të caktohet një kufi p.sh. nga data kur bëhet aerofotografimi nuk do të legalizohet asnjë objekt, pse nuk bëhet kjo te ne, pyeti. Idriz Gashi potencoi tokat që gjenden nën ujitje.

Arben Çitaku fillimisht cekur se Kroacia ka pasur më lehtë të caktoi kufirin ngase më parë ka pasur një Ligj, ndërsa te ne ka pasur probleme fluturakja rreth incizimit të hapësirës së Kosovës për shkak të kufirit me Serbinë, mirëpo tanimë ato probleme janë tejkaluar, tani e kemi edhe datën por ajo është ende sekrete ngase do të krijoheshin vakumet ku mund të ketë invazion të ndërtimeve. Ai kërkoi që te Neni 5 të lihet mundësia e legjislacionit dytësor ngase nuk munden të rregullohen të gjitha problemet me një ligj dhe shprehu pajtimin që të ndahet objekti prej pronës.

Për sekretin e cekur nga sekretari reagues **Nijazi Idrizi** dhe **Liburn Aliu** duke cekur se qytetarët nuk janë njoftuar për të dhe nuk ka logjikë ky punë kështu, mirëpo Arben Çitaku ritheksoi arsyetimin për shkak të sigurimit nga invazioni i ndërtimeve. **Sevdije Lama** konstatoi se në Kroaci kanë shqyrtuar mundësinë e krijimit të një agjencie dhe pyeti a do të ishte mirë të veproi MMPH ngjashëm si në Kroaci lidhur me stafin, duke krijuar një agjenci apo ngjashëm, por sekretari nuk arsyetoi këtë kërkesë, ngase si do të veprohet pastaj me atë staf pas tri viteve. Gjithashtu znj. Lama kërkoi që MMPH përmes lajmërimit të njoftoi popullin se pas përfundimit të aerofotografimit ajror nuk legalizohen ndërtimet pa leje. **Afërdita Berisha** pyeti kush do të kryen punët përfundimtare të rrënimit, ndërsa sekretari u përgjigj se kjo do të jetë kompania e kontraktuar nga MMPH me rimbursime që do të bëhen nga pala rreth dëmeve që do të shkaktohen.

Kryetari Nait Hasani konstatoi se te Neni 2 duhet me një pikë të veçantë të bëhet kategorizimi ndaj duke përfunduar mbledhjen obligoi MMPH të sjellin ndryshimet e kërkuara në këtë mbledhje dhe caktoi takimet e radhës për ditët në vijim.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani